LUTJA E ÇUDITSHME E DIJETARIT PËR DJEMTË E SHTHURUR

PEMA E HURMËS DHE BESIMTARI

IDENTITETI ISLAM, PËRKATËSI QË FTON NË VLERA

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 20 - Nr. 11 (237), Nëntor, 2022

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Lutemi me zemër,
që të mos përsëritet ajo fatkeqësi e atij viti..!

"Sot jemi më 20 nëntor 2022, dhe kjo është pamja e frikshme e përmbytjes, që ka ndodh në 24 orët e fundit, në zonën e xhamisë së Plumbit. Këtu nuk është në diskutim përmbytja e një objekti, si xhamia e Plumbit, që e kemi përzemër dhe është simbol i identitetit tonë islam e kombëtar, por është në diskutim, patjetër dhe mbi të gjitha, situata e familjeve dhe e njerëzve, në shtëpitë përreth..!"

DR. SALAHUDIN KEFTARO: "RIKTHIMIN E LIRISË SË BESIMIT NË SHQIPËRI, E NDOQA ME LOT NË SY!"

(f. 16)

MYFTIU I SHKODRËS: "ME DASHTË VENDIN TËND DHE TOKËN TËNDE, ËSHTË NATYRË ME TË CILËN TË KA SJELLË ZOTI NË KËTË BOTË, SI MËKËMBËSIN E TIJ!"

(f. 13)

LUTJA E ÇUDITSHME E DIJETARIT PËR DJEMTË E SHTHURUR

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të Gjithësisë. Atë e falënderojmë që na udhëzoi në këtë Islam të pastër dhe na solli më të mirin e krijesave të Tij, Hz. Muhammedin (a.s), dëshmi udhëzimi dhe shëmbëlltyrë për gjithsecilin prej nesh deri në ditën e fundit.

Nga këtu, të gjitha salavatet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo moment të jetës sonë, më të mirit e më të shtrenjtit të krijesave të Allahut, Hz. Muhammedit (a.s), jeta e të cilit ishte krejt hajr për ne, e do të jetë kështu deri në ditën e fundit; gjithashtu edhe vdekja e tij ishte hajr për ne, e do të jetë kështu deri në ditën e fundit, sepse sikurse thotë: "Veprat tuaja më shfaqen para duarve, ditën e enjte, e aty ku shoh mirë nga sjellja e veprimi i ymetit tim, e falënderoj Allahun, e aty ku shoh ndryshe, i kërkoj falje Allahut për ju!"

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Prej dëshmive kur'anore të mëshirës së papërshkrueshme të Pejgamberit (a.s) për krijesat e Allahut është edhe ajeti numër 6, i sures El-Kehf, (të cilën e lexojmë si një traditë profetike një herë në javë, ditën e xhuma dhe na e ruan dritën dhe bekimet e Allahut të lidhura si një zinxhirë nuranit (drite) në qenien tonë, deri në xhumanë e ardhshme).

Çfarë thotë Zoti i Gjithësisë për Pejgamberin tonë në këtë ajet?

"A do ta shkatërrosh ti vetën tënde, për shkak të devijimit dhe mos pranimit të tyre, të udhëzimit Hyjnor?"

Pse Zoti i Gjithësisë i drejtohet Pejgamberit (a.s) në këtë mënyrë?

Sepse Hz. Pejgamberi lëndohej nga refuzimi që i bënin mekasit thirrjes së Allahut (xh.sh), mërzitej dhe e vuante gjendjen e tyre, refuzimin si dhe mospranimin e tyre.

Ndaluni pak, e kthehuni shekuj e shekuj pas në kohë, lëreni kohën e Pejgamberit (a.s) dhe shkoni tek Hz. Nuhu.

Nuhu (a.s.), për të cilin Zoti i Gjithësisë na tregon në Kur'anin Famëlartë, se kur e pa që populli i tij nuk po i besonin dhe nuk po e pranonin thirrjen e Allahut (xh.sh), i mallkoi ata dhe iu lut Atij kundër popullit femohues. Këtë e dëshmon shumë mirë sureja, që mban emrin e Hz. Nuhut. Lexojeni dhe shihni në ajetet e para dialogun që ka Hz. Nuhu me Zotin e Gjithësisë, teksa i ankohet dhe i tregon për paudhësinë e popullit të tij. Hz. Nuhu një nga pesë më të mirët e njerëzimit e mallkoi popullin e tij femohues!

Hz. Dauti i mallkoi femohuesit nga beni israilët në popullin e tij; Hz. Isa (a.s.) që është dërguar po ashtu mëshirë në popullin e tij, një ndër pesë më të mirët e njerëzimit, e mallkoi poashtu popullin e tij femohues.

Ndërsa Pejgamberi jonë (a.s.) nga mëshira e Zotit me të cilin e kishte dërguar, i plaste zemra, e rëndonte veten sa herë që dikush e refuzonte apo e kundërshtonte fjalën e Zotit!

"A do ta shkatërrosh ti veten tënde?", Allahu Ekber!

Allahu (xh.sh) e merr me të mirë hatrin e Pejgamberit (a.s), si për t'i thënë: duro, prit, kujdesu për veten tënde se ti je më i shtrenjti, lëri njerëzit sepse, atë që e ka udhëzuar Allahu do të udhëzohet, dhe atë që jo, nuk ka shpresë për të! Por ti mos e lëndo veten tënde, ti mos e shkatërro veten tënde, ti mos u mërzit! Ti kapu pas asaj që të është shpallur dhe kryeje amanetin e thirrjes. "Nuk ka obligim dhe detyrim tjetër i dërguari përveçse të përcjellë fjalën e Zotit". E pranuan, a s'e pranuan...! Ndoshta Pejgamberi jonë (a.s), "i shtinte zor vetes", për hatrin e tyre, sepse ishte dërguar mëshirë për të gjitha krijesat.

Por, le të ndalemi pak këtu. Pse po flas në këtë mënyrë, çfarë dua të nxjerr nëpërmjet këtij detaji shumë të rëndësishëm nga personaliteti, modeli dhe shembulli i Pejgamberit tonë (a.s)?

Dua të them të dashurit e mi, se ne si muslimanë e kemi për detyrë me e mëshiruar, me e dashtë dhe me e ndjekë njëri-tjetrin dhe, me na u djegë zemra për njëri-tjetrin.

Ne si musliman, e kemi haram të distancohemi nga njëri-tjetri, e me i sjellë shpinën njëri-tjetrit. Ne si muslimanë e kemi të ndaluar në fenë tonë ta shikojmë njëri-tjetrit shtrembër. Por, përkundrazi duhet ta ndjekim njëri-tjetrin, të bashkëpunojmë me njëri-tjetrit, me u lodhemi për të shfaqur sinqeritet dhe besnikëri ndaj njëri-tjetrit. Si për t'iu përgjigjur Pejgamberit (a.s) me veprën tonë: Po, Ja Resulullah, jemi muslimanë: "Ai i cili nuk përkujdeset për çështjen e muslimanëve nuk është prej tyre!", siç transmetohet nga sahabiu i nderuar, Hudhejfe Ibnul-Jeman, besniku i sekretit të Pejgamberit (a.s)! *Ti nuk je prej muslimanëve nëse nuk interesohesh për vëllezërit tuaj, për të afërmit tuaj myslimanë! Por me u lutur dhe me punuar fort deri në pragun e ajetit të gjashtë të sures El-Kehf.*

Të dashur, disa nga ne e kanë kuptuar gabim meselenë e udhëzimit, disa prej nesh në vend që dritën e udhëzimit, të cilën e ka sjellë Zoti i Gjithësisë me e marrë si një fener ndriçues brenda

Ne jemi të ftuar mbi të gjitha të ndjekim shembullin e Pejgamberit (a.s) që t'i ftojmë njerëzit me dashni dhe mëshirë dhe mos me e shkatërruar veten, nëse dikush refuzon me e ndjekë këtë rrugë të paqtë!

familjes dhe në shoqërinë e tyre, bëjnë diçka që nuk ka lidhje me Islamin. I rëndojnë të tjerët dhe i lëndojnë ata, përfshi familjarët, si me dashtë me i bë përdhuni me falë namazin, me agjëruar Ramazanin, etj, etj.

Disa prej nesh gabimisht i kanë dhënë kompetencë vetes për t'u bërë dhe gjyqtarë për prindërit, për të afërmit, etj, se nuk falen dhe nuk agjërojnë! Kjo nuk është përgjegjësia jote, nuk je ti përgjegjës as për të gjykuar e as për të rënduar njeri në këtë drejtim. Ti je përgjegjës me e thanë ëmbël fjalën e bukur dhe sa me të mirë. Ti je përgjegjës me u sjellë me njerëzit, muslimanë e jo muslimanë, të afërt apo të largët, me modelin e edukatës tënde islame dhe jo me devijimin tënd brenda kornizës islame.

P.sh, më thotë dikush: "nipi po na e

nxinë jetën", na thotë "ju jeni qafira", "ju jeni të dalur nga feja", "ju s'jeni muslimanë", "ju jeni për xhehenem"..!

Hajr inshalla, çfarë ka ndodhur?! "Ju nuk faleni, ju nuk agjëroni"!

O vëllezër, kjo nuk është metoda e Pejgamberit (a.s). Çfarë do të thotë kjo? Ne nuk jemi përgjegjës t'i ftojmë të tjerët në këtë mënyrë. Ne komunikojmë me të tjerët me të afërmit në veçanti, nëpërmjet mëshirës, dashamirësisë dhe shembullit pozitiv.

Një mik i imi që ka jetuar në Itali disa kohë më parë, më thotë: Një natë me disa nga shokët tanë muslimanë shqiptarë dhe jo shqiptarë, kishim organizuar një mbrëmje fetare me ligjëratë, me ndonjë ilahi, siç zakonisht organizohen gjithandej nëpër botë... Në momentin që po dilnim, një grua e moshuar që ishte komshi me ne, kur na pa duke dalë të gjithë bashkë, u revoltua dhe filloi duke na sharë; "Uleni zërin, na keni trazuar, ju kështu e ju ashtu"! Menjëherë unë së bashku me disa të tjerë shkuam dhe i kërkuam falje, na falni sepse nuk ishte qëllimi t'ju rëndonim, nuk kemi asgjë me ju, ne jemi komshinjtë tuaj, ju kërkojmë ndjesë! Subhanallah! Ashtu siç ishte duke bërtitur, e ndryshoi sjelljen e saj, jo, jo, ju jeni fëmijët e mi! E ndryshoi sjelljen!

Kjo do të thotë që ti, si musliman je i ftuar edhe me jomuslimanin të komunikosh nëpërmjet edukatës tënde. Jo nëpërmjet kapriçove tuaja, jo nëpërmjet zemërimit ose papjekurisë tënde, sepse ky nuk është shembulli i Pejgamberit (a.s). Përndryshe, si e shohim Pejgamberin tonë duke u sjellë mirë dhe duke respektuar dhe duke i shërbyer vetë me duart e tij delegacionit të Nexhashiut, që kishin ardhur në Medine dhe Pejgamberi, që çohet dhe i shërben vetë! Shokët e tij, vinin e i thoshin: Ja Resulullah, ulu se ne i shërbejmë!

Tha: "Jo, sepse këta i kanë nderuar, i kanë strehuar dhe i kanë respektuar shokët tanë". Ka mirënjohje në Islam! Po ata janë jomuslimanë, por edhe pse ishin jomuslimanë, u ngrit vetë Pejgamberi (a.s) me i shërbyer atyre si për t'i thënë faleminderit për shërbimin që na keni bërë; faleminderit me mirënjohje të madhe për çfarë i keni shërbyer sahabëve të mi në momentet më të vështira të jetës së tyre!

Modeli i jonë, të dashur, është modeli i mëshirës, e kemi mësuar. E kemi mësuar dhe marrë begati dhe mirësi nga Allahu (xh.sh) me sened, të lidhur deri te Pejgamberi (a.s), nga hoxha jonë, Shejkh Shuajb Arnauti, hadithin e famshëm: "Mëshironi ata që janë në tokë, t'ju mëshirojë Ai që është në qiell"; "Mëshiruesit, i mëshiron Mëshiruesi!"

O vëllezër, rruga jonë është rruga e mëshirës, komunikimi i muslimanit është me mëshirë dhe dashamirësi ndaj të gjitha krijesave dhe jo me plasë nga brenda, se dikush e ka pranuar apo se, nuk e ka pranuar thirrjen. Me u lutë me zemër për të gjithë të dashurit tanë, për familjarët tanë, për të gjithë ata, që nuk janë siç duhet për me qenë dhe mbi të gjitha me u lutë për vetën që me na mbajtur Allahu (xh. sh) besnikë të kësaj rruge dhe të qëndrueshëm në këtë rrugë, sepse dimë dhe njohim shumë prej bashkudhëtarëve në këtë rrugë të paqtë, që sot as nuk falen e as agjërojnë dhe e kanë shqyer petkun e besimit të Islamit?!

Sa më shumë që të shtohet besimi, aq më tepër shtohet mëshira në zemrën tonë për krijesat e Allahut (xh.sh).

Ma'ruf El-Kerki një nga dijetarët dhe evliatë e mëdhenj të shekullit të kaluar, së bashku me një grup prej studentëve të tij dhe diku në sfond dëgjohet një zhurmë e madhe një dëfrim, (si disa dëfrime e shthurje që ndodhin këtu në zemër të lagjeve tona, kur organizohen festat e shthurjes e të degjenerimit në emër të argëtimit të Shkodrës, këtu përpara Bashkisë...). Studentët i thanë hoxhës së tyre: Lutju Allahut kundër tyre, mallkoi ata! Ai çfarë tha? Tha një fjalë shumë të madhe: "Allahumme (O Zoti ynë) , siç i ke gëzuar në këtë botë, gëzoi nesër në ditën e gjykimit, ja Allah"! Studentët u habitën dhe i thanë: Hoxhë si me i gëzuar këta në ditën e gjykimit, këta janë në shthurje?! Ai iu përgjigj: Unë nuk i mallkova, unë u luta nga pozita e jonë, nga pozita e mëshirës, sepse nëse Allahu (xh.sh) e pranon lutjen time dhe do t'i gëzojë nesër në ditën e gjykimit, do të thotë se pa mbërritur dita e gjykimit dhe pa ardhur exheli i tyre, Allahu (xh.sh) do t'i udhëzojë dhe do t'i kthejë nga e mbara dhe do t'i bëjë nga ata, që e meritojnë mëshirën e Allahut, e faljen e bekimet e Tij dhe nesër, do të jenë nga të gëzuarit në jetën e përtejme!

Të dashur, ne nuk kemi të keqe edhe nëse të shthururit në mesin tonë udhëzohen me këtë Islam, por ne jemi të ftuar mbi të gjitha të ndjekim shembullin e Pejgamberit (a.s) që t'i ftojmë njerëzit me dashni dhe mëshirë dhe mos me e shkatërruar veten, nëse dikush refuzon me e ndjekë këtë rrugë të paqtë!

Allahu ju dashtë dhe ju bekoftë!

Diktoi: **Siditë Hafizi**

LUTJET TONA ME POPULLIN VËLLA TURK!

"

Me hidhërim të thellë morëm lajmin e shpërthimit terrorist në zemër të lagjes Taksim, në qytetin e dashur të Stambollit.

Fytyra e terrorizmit dhe mbështetësve të tij, ka qenë përherë e zezë! E tillë do të jetë deri në kiamet, pavarësisht kushteve, rrethanave dhe kujdestarëve të tij!

Në Islam, kushdo që nxit terror e dhunë, është i përbuzur, i refuzuar dhe i dënueshëm, sepse jetën, Zoti na e ka dhënë për ta jetuar sipas vullnetit të Tij, larg cytjeve të shejtanit, urrejtjes dhe smirës, frikës nga lartësimi i të mirës dhe afirmimi i vlerave!

Në këtë kontekst, bashkohemi me dhimbjen e vëllezërve tanë në Türkiye dhe lutemi përherë për progresin, përparimin, mirëqenien dhe sigurinë e këtij vendi të madh e popullit vëlla turk!

Allahu e begatoftë Türkiyen, popullin e saj dhe e ruajt nga tentakulat e dëshpëruara të së keqes që vërshojnë drejt saj e drejt çdo vendi, populli e toke në këtë botë, ku jemi kalimtar dhe të ftuar për të mbjellë paqe, zhvillim e mirësi!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 13 nëntor 2022

PEMA E HURMËS DHE BESIMTARI

"Cila është ajo pemë, të cilës nuk i bien gjethet dhe qësi shembull i përngjet muslimanit-besimtarit?"

Sahabët filluan t'i renditnin pemët e shkretëtirës, por nuk po u shkonte mendja dot se cila ishte ajo. Mua, - thotë Abdullah ibn Umeri, - më vajti mendja tek pema e hurmës (palmës), por nga turpi, meqë isha më i vogli, nuk fola.

Atëherë Pejgamberi (a.s) tha: "Ajo është pema e hurmës."

Naim Drijaj
Imam - Xhamia Parrucë

Abdullah ibn Umeri tregon se Profeti (a.s) në një tubim me sahabët, i pyeti ata: "Cila është ajo pemë të cilës nuk i bien gjethet dhe që si shembull i përngjet muslimanit-besimtarit?"

Sahabët filluan t'i renditnin pemët e shkretëtirës, por nuk po u shkonte mendja dot se cila ishte ajo. "Mua, - thotë Abdullah ibn Umeri, - më vajti mendja tek pema e hurmës (palmës), por nga turpi, meqë isha më i vogli, nuk fola."

Atëherë Pejgamberi (a.s) tha: "Ajo është pema e hurmës." Abdullahi më pas tregon: Unë ia tregova babait për atë që më erdhi në mendje, por më erdhi turp ta them, e ai më tha: "Sikur ta kishe thënë, do të ishte më e dashur për mua, sesa të kem këtë e atë."[1]

URTËSITË E PËRBASHKËTA MIDIS BESIMTARIT DHE PEMËS SË HURMËS

Ibn Kajimi në librin e tij "Miftahu Daris-Saade"[2] në lidhje me këtë hadith ka nxjerrë shumë urtësi ku ndër ta mund të përmendim:

1. Pema e hurmës është e njohur me qëndrueshmërinë e saj dhe rrënjët i ka të ngulura thellë në tokë. Ajo është e qëndrueshme ndaj thatësirës dhe ndryshimeve atmosferike, i përshtatet ambienteve klimatike, nuk thyhet kollaj para stuhive. Po kështu, besimtari është i qëndrueshëm dhe i palëkundur, pasi rrënjët e tij i ka të ngulitura thellë në besimin që ka përqafuar dhe e din se cili është qëllimi i tij në këtë botë. Nuk i bëjnë përshtypje thirrjet djathtas e majtas është i qëndrueshëm, nuk ndryshon dhe nuk ngjyroset për çfarëdo interesi të caktuar të kësaj bote.

2. Ekzistojnë lloje të ndryshme të hurmave, por të gjitha janë të ëmbla. Gjithashtu ekzistojnë edhe lloje të ndryshme të mollëve, por të gjitha nuk janë të ëmbla. Po ashtu edhe besimtari është i dobishëm atëherë kur fjalët i ka të ëmbla dhe veprat i ka të mira. Kujdes se me fjalët e tua mund të rrënosh shumë gjëra, që vetë i ke ndërtuar.

I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Musliman është ai, prej të cilit muslimanët janë të sigurt nga gjuha dhe dora e tij."[3]

3. Pema e hurmës karakterizohet me një petk, i cili e ka mbështjellë atë dhe nuk zhvishet kurrë prej tij. Pemëve të tjera u bie lëvozhga, por hurma është e veshur gjithmonë me petkun e saj përkundër stinëve. Po petku yt cili është o besimtar? Allahu (xh.sh) thotë: "Petku i devotshmërisë është më i miri."[4] Pra, Allahu i Madhëruar, devotshmërinë e quan petk. Besimtari është sikur hurma, gjithmonë është i veshur me devotshmëri, frikë ndaj Allahut dhe me vepra që e mbrojnë atë nga zjarri i xhehenemit. Besimtari asnjëherë nuk duhet ta ndërrojë petkun e devotshmërisë, por gjithmonë duhet të jetë i devotshëm e jo vetëm në raste të veçanta. Ibn Mubareku ka thënë: "Sa njerëz të këqij janë ata, që nuk e njohin Zotin, përveçse në Ramazan."

4. Pema e hurmës është e tillë, që frutat i vilen shumë kollaj edhe pse është e lartë. Kjo pasi struktura e saj ta mundëson që t'i ngjitesh deri në majë. Ngjitja në hurmë, nuk dëmton as gjethet e saj, as degët, as lëkurën dhe as sythet e saj. I tillë është dhe besimtari, frytet e të cilit vilen kollaj. Ai duhet të ndihmojë të tjerët duke i dashur njerëzit dhe duke u gjendur pranë kur ata kanë nevojë. Në çdo situatë, ai nuk duhet t'i braktisë moralet dhe vlerat islame.

Junus bin Abdul-A'la merrte pjesë në mësimet e imam Shafiut dhe një herë debatoi me të për një çështje, për të cilën nuk ra dakord me mësuesin e tij dhe u ngrit, e u largua i zemëruar nga mësimi. Në mbrëmje dikush troket në portën e shtëpisë së tij. Junusi pyeti: Kush është? Trokitësi i thotë: Muhamed ibn Idris (emri i Shafiut, v.204/820).

Unë – thotë Junusi – po mendohesha se kush tjetër, përveç Shafiut quhej me këtë emër, sepse nuk mendoja që mund të jetë ai, por kur hapa portën shoh fytyrën e buzëqeshur të Shafiut, i cili më tha: "O Junus, ne na bashkojnë me mijëra çështje, a dëshiron të ndahesh për shkak të një mospajtimi? Mos tento që në çdo mospajtim të dalësh fitimtar, sepse shpeshherë më e rëndësishme është të fitosh zemrat dhe jo debatet. Mos i shemb urat që ndërtove dhe nëpër to kalove, sepse mund të të duhet që të rikthehesh përsëri përmes tyre. Çdo herë urreje gabimin, por asnjëherë mos e urre gabimtarin, urreje me qenien tënde gjynahun, por fale dhe mëshiroje gjynahqarin. Kundërshtoje fjalën, por respektoje thënësin. Qëllimi ynë është që të shërojmë sëmundje dhe jo të vrasim të sëmurë!"

5. Pema e hurmës është e dobishme me gjithçka që ajo ka, me rrënjët, trungun, degët, gjethet, frutat, hijen që lëshon dhe bukurinë e rrallë që ka. Kështu duhet të jetë edhe besimtari, kurdo dhe kudo që ndodhet, ai duhet të jetë i dobishëm për të tjerët, me dijet e tij, moralet, pasurinë, përpjekjet personale, bisedat, ushqimin, veprat, forcën, urdhërimin për mirë dhe ndalimin nga e keqja, bashkëpunimin për vepra të mira dhe devocion, mëshirën, kontaktet dhe solidaritetin me shoqërinë ku jeton.

Ibn Kajimi në një libër tjetër thotë: "Sot fatkeqësisht gjejmë njerëz që falen natën, agjërojnë ditën dhe ndjekin safin e parë e në disa aspekte janë shumë të kujdesshëm, mirëpo njerëzit nuk janë të qetë nga gjuha e tij, nga përgojimi, shpifja, bartja e fjalëve, akuzat, ofendimet etj." Ashtu siç hurma është gjithmonë e dobishme edhe besimtari duhet të jetë produktiv në çdo kohë dhe vend.

Një ditë, Llukmani i mençur i tha djalit të tij: "O biri im! Gjëja e parë që duhet të fitosh në jetë, pas besimit tek Zoti, është një mik i mirë. Një mik i mirë dhe i ndershëm, i ngjan hurmës (palmës). Nëse shtrihesh nën hijen e saj, të mbron nga rrezet e diellit, nëse e pret për dru zjarri, të ngroh dhe nëse e merr nga frytet e saj, të ushqen.

6. Nëse hurmën e gjuan me gurë, ajo ta kthen me frutat e saj të ëmbla. Kështu duhet të jetë edhe besimtari, zemërgjerë dhe falës duke mos u sjellë padrejtësisht me të tjerët dhe duke mos u hakmarrë ndaj të paditurve.

Poeti arab thotë:

Si palma e lartë, askujt mos i mbaj mëri
Me gurë në të qëllofshin, fruta lëshoju ti!

7. Sa më shumë që hurma vjetërsohet, aq më shumë jep fruta dhe i rritet cilësia. Kështu duhet të jetë edhe besimtari. Sa më shumë që të jetojë, aq më shumë duhet të bëjë vepra të mira. Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë) thotë,[5] se një njeri të urtë e kishin pyetur: "Kush është shoku më i mirë?" Ai u përgjigj: "Vepra e mirë!"

Për Ahmed ibn Hanbelin (mëshira e Allahut qoftë mbi të), njëri prej nxënësve të tij thotë: "E kam shoqëruar Imam Ahmedin njëzet vjet. Ai i shtonte veprat e mira çdo ditë."[6] Nuk dihet se me çka e fiton njeriu. Dikush hyri në xhenet për shkak të largimit të një pengese nga rruga[7], dikush hyri në xhenet për një qen[8], e dikush tjetër hyri në xhehenem për një mace.[9]

Vlera e vërtetë është në të vepruarit mirë dhe jo në të jetuarit gjatë, sikurse na njofton Profeti (a.s) kur thotë: "Njeriu më i mirë është ai që jeton më gjatë dhe bën vepra të mira."[10] Pra, nëse jeton, dije se Zoti të ka dhënë një mundësi shtesë për t'u përmirësuar, ndryshe, ditët dhe vitet do të jenë dëshmi kundër teje.

Nuk është shumë e rëndësishme se si do ta japin lamtumirën (përcjellin) banorët e tokës, por e rëndësishme është se si do të presin banorët e qiellit.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Me të vërtetë, veprat janë sipas përfundimit të tyre!"[11]

1. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
2. Miftahu Daris-Saade/Saadet Yurdunun Anahtarı.İbn Kayyim el-Cevziyye.Beka Yayınları, Ekim 2017. 1/ 529-535.
3. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
4. Kurani, El-Araf: 26.
5. Në librin e tij "Reudatul-Muhibin".
6. El-Hilje.
7. Buhariu, 652; Muslimi, 1914.
8. Buhariu, 3467; Muslimi, 2245.
9. Buhariu, 745; Muslimi, 2619.
10. Tirmidhiu, 2330.
11. Buhariu, 6607.

16 NËNTORI 1990

KRYEFJALË E NJË EPOKE TË RE NDRYSHIMI PËR SHQIPËRINË DHE KOMBIN SHQIPTAR!

Në këtë datë të shënuar të 16 nëntorit, 32 vjet më parë, pikërisht më 16 nëntor 1990, u zhvillua ceremonia madhështore e faljes së xhumasë së parë në liri, pas 23 vitesh diktaturë dhe terror ndaj popullit dhe besimit në Shkodër e mbarë Shqipërinë.

Atë ditë, xhamia e Plumbit, Hafiz Sabri Koçi dhe Shkodra, ishin kryefjalë e një epoke të re ndryshimi për Shqipërinë dhe kombin shqiptar!

Rahmet u pastë shpirti të gjithë atyre burrave e grave besimtare, të cilit ishin të pranishëm atë ditë, por që sot nuk jetojnë më, dhe atyre, të cilët janë gjallë prej tyre, Zoti u dhashtë shëndet dhe jetë të gjatë!

Mbetemi me shpresë, se vitin e ardhshëm, xhamia e Plumbit, të jetë e zbukuruar siç i takon, pas rregullimit, që po i bëhet vetë xhamisë, por edhe oborrit përreth saj.

IDENTITETI ISLAM, PËRKATËSI QË FTON NË VLERA

Vlerat që burojnë nga përkatësia ndaj identitetit islam janë të shumta, por këtu do të ndalemi në katër prej tyre, si më të rëndësishme e më aktualet për kohën në të cilën jetojmë:

Prej vlerave të Identitetit Islam janë:

- Bartja e identitetit Islam ngarkon me përgjegjësi.

- Përkatësia ndaj identitetit islam sjell ekuilibër mes dimensionit fizik dhe atij shpirtëror.

- Përkatësia ndaj identitetit islam zgjon ndjenja reaguese.

- Identiteti islam, për ndjekësit e tij, është kurorë vlerash.

Në shkrimin e kaluar, trajtuam "Identitetin në kornizën e islamit". Folëm për konceptin e identitetit, kuptimin që mbart ai, e në veçanti për konceptin e identitetit islam dhe tiparet e tij. Ndërsa, në këtë shkrim, do t'i qasemi identitetit islam në një këndvështrim pak më ndryshe, do të përmendim vlerat që ky identitet ia shton individit që e bart atë. Pra, për vlerat që na jep përkatësia ndaj identitetit islam.

Vlerat që burojnë nga përkatësia ndaj identitetit islam janë të shumta, por këtu do të ndalemi në katër prej tyre, si më të rëndësishme e më aktualet për kohën në të cilën jetojmë:

Prej vlerave të Identitetit Islam janë:

- Bartja e identitetit Islam ngarkon me përgjegjësi.

- Përkatësia ndaj identitetit islam sjell ekuilibër mes dimensionit fizik dhe atij shpirtëror.

- Përkatësia ndaj identitetit islam zgjon ndjenja reaguese.

- Identiteti islam, për ndjekësit e tij, është kurorë vlerash.

1. Bartja e identitetit islam na ngarkon me përgjegjësi

Të përqafosh identitetin islam do të thotë të mbash përgjegjësi, sepse ndryshe nuk mund të jesh mëkëmbës i Allahut në tokë. Kjo përgjegjësi peshon rendë dhe kërkon angazhim nga ana jonë për ta mbajtur. Çdo veprim i yni, që nga marrja e abdesit, përgatitja për namaz, vendosja e kokës në sexhde, përshëndetja me njëri-tjetrin, leximi dhe dëgjimi i Kuranit, etj, janë pjesë e këtij angazhimi ndaj përgjegjësisë. Por, kjo përgjegjësi nuk kufizohet vetëm në rrafshin individual, ajo shtrihet edhe në atë shoqëror. Të jesh përgjegjës do të thotë të kesh një shkallë të lartë të zhvillimit shpirtëror, shoqëror, kulturor e material, dhe njëkohësisht të mos jesh imitues i verbër i të tjerëve, sepse përndryshe mund të llogaritësh si i tjetërsuar e kështu mund të asimilohesh lehtësisht. Këtë e ka theksuar edhe Profeti ynë i dashur kur ka thënë: "Kushdo që imiton një popull, ai bëhet prej tyre".[1]

Shfaqja e identitetit tonë ka shumë rëndësi, sepse po shohim që brezat e rinj po shkëputen, çdo ditë e më tepër, nga vlerat islame dhe po enden të hutuar nëpër kaosin shoqëror të krijuar nga deformimi i koncepteve dhe vlerave. Pak e nga pak, kemi filluar të largohemi nga qartësia e identitetit tonë, në emër të shumicës, të shumëllojshmërisë së mendimeve e të dialogut mes qytetërimeve. Jemi duke e kufizuar identitetin tonë vetëm brenda xhamive, ndërkohë që duhet ta shfaqim kudo.

Të tregohesh i përgjegjshëm, bart një rëndësi të veçantë në vetvete, sidomos për atë që do t'i transmetohet brezit të ri. Të mbash përgjegjësi do të thotë të kesh dinjitet, të kesh pavarësi në vendimet tuaja, por edhe të kesh durim e forcë për t'u përballur me pasojat e veprimeve tuaja, qofshin pozitive apo negative. Të mbash përgjegjësinë e ruajtjes së përkatësisë dhe identitetit tënd, do të thotë të mos joshesh nga çdo gjë e popujve të tjerë, as të jesh imitues apo viktimë e qytetërimeve të tjera, por të besosh bindshëm në atë që je, në atë që bën dhe të përpiqesh të ruash rolin që të takon në shoqëri.

Shpeshherë, e kemi të vështirë t'i dallojmë fëmijët tanë, se çfarë përkatësie kanë apo bartin. Disa prej tyre nuk dallohen as nga emri, sepse po bartin emra nga më të çuditshmit, e shpesh të pakuptimtë. Por nuk i dallojmë as nga veshja, e as nga qëndrimet dhe sjelljet e tyre. Për të gjitha këto përgjegjësia bie mbi prindin, i cili do të japë llogari jo vetëm për vete, por edhe për emrin që i ka vënë fëmijës, e për shumë gjëra të tjera. Justifikimi më i shpeshtë për këtë është, se kështu është koha. E vërtetë se është koha e tillë dhe fëmijët do t'i rrisim e do t'i edukojmë për kohën në të cilën ata jetojnë, por nuk duhet hequr dorë nga vlerat dhe përkatësia të cilës i përkasim.

Aliu (r.a), për edukimin e fëmijëve, ka kështilluar: "Edukojini fëmijët tuaj përtej asaj që jeni edukuar ju, sepse ata janë krijuar në një kohë përtej kohës tuaj."[2] Prandaj, duhet të tregojmë një kujdes të veçantë ndaj edukimit dhe arsimimit fetar të fëmijëve tanë. Nuk duhet të anashkalojmë nevojat elementare të edukimit fetar, të cilat në kuptimin më të ngushtë, nisin me edukimin fetar të fëmijës në familje, e plotësohen me mësimin fetar në shkollë. Ky edukim do të jetë një ndihmë e madhe për fëmijët dhe të rinjtë, që jo vetëm të kenë një shoqëri të mirë dhe t'i përkasin këtij identiteti, por edhe t'i mbartin vlerat e tij tek të tjerët. Prandaj, është një domosdoshmëri që t'i përshtatemi kohës dhe vendit në të cilin jetojmë, por duke mos anashkaluar parimet themelore të fesë sonë, e duke bartur identitetin tonë fetar.

Gjithashtu duhet të theksojmë se përgjegjshmëria jonë lidhet ngushtë me një varg cilësish të tjera pozitive tek individi, si devotshmëria, morali, drejtësia, modestia, serioziteti, butësia, dashamirësia, etj, Cilësi që identiteti islam i kultivon tek bartësit e vet, nëpërmjet shpalljes hyjnore dhe traditës profetike. Shembujt dhe modelet që ne marrim janë profetët e Allahut, e në veçanti Pejgamberin Muhammed (a.s), si njeriun me moralin më të mirë dhe me virtytet më të larta njerëzore. Allahu (xh.sh), në Kuran, thotë: "Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë për njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar për ju..."[3]

1. Transmetuar nga Ebu Davudi, hadith i saktë.

2. El-Hivarul-Mutemeddin, Hadi Nasir Seid El-Bakir, nr. 2506.

3. Kur'ani, El-Bekare: 143.

E, për të qenë dëshmitarë, është e nevojshme të jemi shembuj. Të qenit shembull kërkon sjellje të përgjegjshme, që do të thotë të tregohesh i kujdesshëm në çdo veprim që bën.

Këtu lindin pyetjet:

1. A jemi ne të përgjegjshëm?

2. A jemi ne shembull i mirë për brezat e rinj?

3. A jemi ne bartësit e identitetit islam, si mëkëmbës (kalif) të Zotit në tokë?

4. A duhet të përpiqemi më tepër për këtë identitet, pasi ta kemi kuptuar rëndësinë dhe vlerat që mbart ky identitet?

2. Përkatësia ndaj identitetit islam sjell ekuilibër mes dimensionit fizik dhe atij shpirtëror

Sikurse e dimë, njeriu përbëhet nga trupi dhe shpirti, pra ai ka dy elemente për të ekuilibruar, elementin tokësor dhe elementin hyjnor.

Meqenëse identiteti Islam përkufizimin e merr nëpërmjet shpalljes, ai përmban një veçori, e cila nuk kufizohet vetëm në këtë botë e nuk përfundon vetëm me të dhënat fizike të saj, por shtrihet deri në pafundësinë e Ahiretit, ku synon kënaqësinë e Allahut. Kështu, identiteti islam synon të vendosë, në nivelin personal të çdo individi, ekuilibrin mes fizikes dhe shpirtërores. Prandaj, në nivelin jetësor, ai përfshin dy dimensionet: dimensionin tokësor dhe dimensionin e jetës tjetër (të Ahiretit).

Ndërkohë, ai njeri, i cili nuk e vendos harmoninë mes baltës dhe shpirtit, nuk do të arrijë të realizojë kuptimin e jetës së tij në tokë. Ai do të bëhet i huaj në thelbin e tij, sepse shkëputja e tij nga shpirti do të thotë ngecje në baltë.

Shoqëria po vuan nga rënia shpirtërore, e cila vjen si rezultat i pakujdesisë ndaj ushqimit shpirtëror. Shohim shumë njerëz që vrapojnë vetëm pas të mirave materiale. Ata kujdesen vetëm për mirëqenien e tyre në këtë botë, duke e harruar atë të botës tjetër (Ahiretit). Njeriu po përjeton një luftë të brendshme mes materies dhe shpirtit, gjë që po e bën atë të ndjehet i pakënaqur, pavarësisht sa ka arritur dhe çfarë posedon në jetë. Njeriu gjendet mes dy realitetesh, njëri konkret (dynjaja) e tjetri abstrakt (Ahireti), por që të ruajë balancën, atij i duhet një mbështetje, e cila nuk arrihet vetëm se me përkatësinë ndaj identitetit islam. Allahu (xh.sh) na ka mësuar, që kur të dëshirojmë mirësi, të lutemi në këtë formë: "Zoti ynë, na jep mirësi edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit të zjarrit!"[4]

Nëpërmjet kësaj lutjeje, ne i kërkojmë Allahut të na japë mirësi në të dyja botët, njësoj si për dynjanë, ashtu edhe për ahiretin, pa asnjë dallim mes tyre. Gjithashtu, Allahu (xh.sh) na porosit të mos e harrojmë jetesën tonë në këtë botë, duke thënë: "...dhe përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh botën tjetër, por mos harro as pjesën tënde në këtë botë... "[5]

Prandaj, ekuilibrin e duhur, njeriu mund ta arrijë vetëm me peshoren e Islamit, që është e përpiktë, si për anën shpirtërore, ashtu edhe për atë materiale; si për këtë botë, ashtu edhe për botën tjetër.

Kështu që, kur të analizojmë përkatësinë tonë, duhet të kemi parasysh të parashtrojmë pyetjet:

- A jemi në radhët e "atyre me të cilët Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë te kënaqur me Të"?!

- A na mundëson identitet ynë, arritjen e kënaqësisë në këtë botë dhe në botën e ardhshme (të Ahiretit)?!

- A e gjejmë veten tek ajetet kuranore: "Dhe hyr në mesin e robërve të Mi, dhe hyr në Xhenetin Tim[6]. ?!

Nëse po, atëherë jo vetëm jemi bërë pjesë e identitetit islam, por edhe kemi arritur ekuilibrin mes dy dimensioneve, (dynjasë e Ahiretit; trupit e shpirtit)

3. Përkatësia ndaj identitetit islam zgjon ndjenja reaguese

Identitet do të thotë të marrësh vendim se kush je dhe të përcaktosh vlerat që të përkasin. Por, jo vetëm kaq... Një pjesë e identitetit të njeriut kuptohet edhe nga qëndrimet e që ai mban, qofshin ato qëndrime pohuese apo kundërshtuese ndaj një fenomeni të caktuar. Është shumë e thjeshtë të jesh pohues në çdo gjë, të pranosh çdo gjë pa e gjykuar, apo pa i menduar pasojat. Shpesh, ne u referohemi vlerave me të cilat pajtohemi, por sa shpesh reflektojmë për ato gjëra ndaj të cilave duhet të pozicionohemi kundër?!

Përveç pyetjes "Kush jam unë?", a i keni drejtuar ndonjëherë vetes pyetjen: "Kush nuk jam unë?"

Nëse po, gjë për të cilën, mendoj se rrallë ka ndodhur, "Ku nuk e keni gjetur veten tuaj?"

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme, por një gjë dihet, që nuk e keni gjetur veten tek gjërat, të cilat ju dëmtojnë dhe kanë pasoja negative për ju. Nëse nuk e keni gjetur veten në të ndaluarën, por keni reaguar ndaj një fenomeni negativ, etj, do të thotë se ju i jeni përmbajtur identitetit islam. Sepse identiteti islam nuk pranon gjithçka që i ofrohet, ai është reagues, por edhe i matur. Si rezultat, muslimani reflekton ndaj fenomeneve negative dhe reagon ndaj tyre. Ai nuk i nënshtrohet askujt tjetër, përveç Zotit, nuk u nënshtrohet presioneve, nuk heq dorë nga e vërteta, por mundohet gjithmonë të ftojë në të mirë dhe të ndalojë nga e keqja.

Shembull për këtë kemi rastin e muslimanëve të parë, që emigruan në Abisini, për t'iu larguar keqtrajtimeve dhe torturave që kishin nga Kurejshët në Mekë. Kur mbërritën atje, u takuan me Nexhashiun, mbretin e Abisinisë, por ata nuk u përkulën para tij, siç ishte zakoni i nderimit ndaj mbretërve në atë kohë dhe siç e kishin zakon vendasit. Në këtë moment njëri nga këshilltarët e mbretit i pyeti:

- Përse nuk u përkulët para mbretit tonë?

- Ne përkulemi vetëm para Allahut, - iu përgjigjën ata.

Prandaj, të bartësh identitetin islam,

4. Kur'ani, El-Bekare: 201.

5. Kur'ani, El-Kasas: 77.

6. Kur'ani, El-Fexher: 29-30.

NDJENJAT FETARE TË INDIVIDIT NË PERIUDHËN PARASHKOLLORE

Besim Barbullushi
Imam - Xhamia Rus

Zhvillimet bashkëkohore në ndjenjat fetare dhe edukimin e fëmijëve, të cilët janë pasuria më e vlefshme e familjes, duhen ndjekur në dritën e shkencës. Me moshën parashkollore nënkuptojmë fëmijët e grupmoshës 2-5 vjeç. Në vendin tonë një pjesë e fëmijëve të këtyre grupmoshave shkollohen në familje dhe një pjesë e tyre në institucionet parashkollore. Në sistemin tonë arsimor kombëtar, synohet rritja e fëmijëve me një personalitet dhe karakter të ekuilibruar dhe të shëndetshëm për sa i përket trupit, mendjes, moralit, shpirtit dhe emocionet. Për të siguruar këtë zhvillim të ekuilibruar tek fëmijët, detyrë madhore ka edhe familja si institucion arsimor, pra prindërit.

Zhvillimet tek fëmijët që përbëjnë periudhën parashkollore vazhdojnë në mënyrë të shumëanshme sipas përcaktimeve të psikologjisë dhe pedagogjisë. Fëmijët, të cilët zakonisht fillojnë të flasin në moshën e dytë, gradualisht fillojnë të flasin për fjalë, qoftë edhe me emocion, kuriozitet, dashuri apo frikë, në mënyrë të pavetëdijshme, në varësi të karakteristikave të mjedisit familjar dhe mjedisit ku jetojnë. Nga mosha e tretë ata duan të vazhdojnë dhe zhvillojnë marrëdhëniet e tyre me mjedisin e tyre. Moshat 3-4 janë periudha kur fëmijët janë në dispozicion për të marrë sugjerime, për të imituar, për të bërë krahasime. Këto vite janë jashtëzakonisht të rëndësishme për edukimin e individit në mjedisin familjar. Ata duan të bëjnë dhe të mësojnë atë që shohin dhe dëgjojnë.

Mosha e katërt është periudha kur ëndrrat e fëmijëve fillojnë të forcohen. Gjatë kësaj periudhe, ata mund të ngatërrojnë atë që shohin në realitet me ëndrrat që kanë ndërtuar dhe zhvilluar në mendjet e tyre. Prandaj, tek fëmijët e kësaj moshe vërehen zhvillime të shumëanshme. Individi që ka shumë emocione është gjithashtu i interesuar në mënyrë të pavetëdijshme për atë që sheh dhe dëgjon në fushën e fesë. Në këtë periudhë zgjimi fetar dhe ndjenja fetare tek fëmijët mund të shfaqet në varësi të mjedisit familjar ku ata jetojnë.

Tema se kur fillon të formohet ndjenja e fesë tek fëmijët dhe çfarë procesi ndjek ajo ka hyrë në fushën e shkencës dhe shkencëtarëve. Ndërsa ka qarqe shkencore që pretendojnë se ndjenja e fesë fillon tek fëmijët në moshat e hershme, ka edhe nga ata që pretendojnë se kjo ndjenjë fillon në moshat e mëvonshme (12-15). W.James, Erasmus, Spencer, Scheler, Herbart, Fröbel në botën e arsimit perëndimor; Ndërsa shkencëtarët si Ibn Sahnun, Farabi, Ibn Sina, Imam Eafii, Gazaliu dhe Mevlana në botën islame pohuan se ndjenja e fesë filloi në fëmijërinë e hershme. Mendimtarë si: H. Lisager dhe J.J.Rousseau pohuan se ndjenja fetare fillon më vonë.

Në vend që të shprehen këto dy pikëpamje me vija të mprehta, mjedisi kulturor dhe mjedisi në familjen ku është rritur individi luajnë një rol vendimtar në këtë drejtim. Sepse vitet e para të individit kalojnë në mjedisin familjar. Mjedisi familjar është institucioni i parë arsimor në botën e fëmijës, si formalisht ashtu edhe joformalisht. Sipas psikologëve, sidomos në pyetjet, ndër emocionet spontane tek fëmijët e moshës 4-6 vjeç mund të gjendet një ndjenjë feje. Ky emocion, si emocionet e tjera, është potencialisht në natyrën e fëmijës dhe mund të shfaqet në mjedise të përshtatshme. Ka edhe nga ata që theksojnë se zgjimi dhe aktiviteti i ndjenjës fetare përkon me zhvillimin mendor dhe shpirtëror të fëmijës.

Ndjenja fetare tek fëmijët është gjithashtu e rëndësishme për sa i përket zhvillimit të tyre shpirtëror dhe shëndetit mendor. Sepse ata kanë prirje drejt fesë. Studimet në psikologjinë e fesë theksojnë se fëmija nuk është i huaj me fenë shpirtërisht, përkundrazi, ai ka një besim fetar të tijin. Po kështu, përvojat pedagogjike kanë zbuluar ekzistencën e një potenciali të madh fetar tek fëmijët.

Takimet e fëmijëve me besimin në

Allahun fillojnë që në moshë të re. Ky takim i shton një pasuri emocionale botës së fëmijës. Kjo mund të kuptohet më mirë nga interesi i tij i veçantë për të mësuar rreth Zotit dhe fesë. Ky interes i veçantë mund t'i çojë fëmijët drejt pjekurisë emocionale me kalimin e kohës. Si rezultat i hulumtimeve në terren, u zbulua se fëmija ka një interes të gjallë për fenë, me kuriozitet dëshiron të mësojë dhe kuptojë Zotin dhe ka dëshirë për praktika fetare si namazi dhe duaja që në moshë të vogël, nga ana tjetër shfaq një përpjekje për mësim ndaj koncepteve fetare.

Fëmijët e grupmoshës 5-6 vjeç mund ta konceptojnë natyrshëm Zotin me cilësi njerëzore. Është e mundur të gjesh diçka nga elementët fizikë dhe sfera e emocioneve në çdo koncept dhe përpjekje njohëse që ata përdorin për Allahun. Ata mund të bëjnë përpjekje për të mishëruar konceptet dhe ngjarjet që u duken abstrakte ndërsa i perceptojnë në botën e tyre. Mund të shihen përpjekjet e tyre për të mishëruar Zotin në pyetjet dhe kualifikimet e tyre: Ata thonë: "Zoti është në qiell, mbi re, në ajër, në parajsë, kudo, në zemrat tona, ne nuk mund ta shohim Zotin, sepse ai është aq lart, fytyra e Zotit është e ëmbël, mjekra e bardhë, bijtë e Zotit, Ai do shumë, ka shtëpinë e Allahut, është shumë e bukur..." etj.

Ata përpiqen të konkretizojnë njohuritë e tyre për Allahun me përdorimin e përshkrimeve. Në këtë dhe studime të ngjashme në terren, zbulohet se fëmijët janë më kuriozë për Allahun, dhe ata mendojnë dhe përpiqen ta kuptojnë Allahun brenda kornizës së fuqive të tyre mendore dhe shpirtërore si gjatë periudhës së arsimit parashkollor ashtu edhe atij fillor. Ata kanë të bëjnë kryesisht me esencën e Allahut, veprimet e Tij, krijimin dhe krijesat e Tij. Shumë faktorë ndikojnë që fëmijët të kenë një besim të tillë. Këto janë tema të besimit të lehtë, prirjes, përgatitjes fetare dhe harmonisë.

Fëmijët reflektojnë kërkimin dhe dëshirën e tyre për Allahun që në moshë të hershme. Ndërsa ata besojnë në Allahun, ata besojnë pa kundërshtuar, pa dyshuar, pa hetuar arsyen. Megjithatë, duhet theksuar se një nga veçoritë karakteristike të fesë së fëmijëve është se zhvillimi fetar ende nuk është formuar plotësisht dhe nuk ka arritur disa parime. Pavarësisht kësaj, nuk duhet mbajtur larg vëmendjes dhe syve se besimi i fëmijës është i natyrshëm. do të thotë, të shfaqësh rezistencë dhe vigjilencë ndaj imponimeve, të cilat nuk janë pjesë dhe janë në kundërshtim me besimin tonë.

4. Identiteti islam, për ndjekësit e tij, është kurorë vlerash

Njeriu ka vlerë, aq sa i ka dhënë Allahu vlerë atij. Kjo vlerë është shumë e veçantë. Allahu, jo vetëm që e ka krijuar njeriun dhe ka krijuar gjërat e tjera në ndihmë të tij, por e ka dalluar atë mbi krijesat e tjera, duke e pajisur edhe me mendje dhe vullnet për të zgjedhur. Allahu xh.shthotë: "Është Ai, që për ju ka krijuar çdo gjë që ka mbi tokë. Pastaj, i është drejtuar qiellit dhe e ka rregulluar, duke e bërë atë shtatë qiej. Ai është i Dijshëm për çdo gjë."[7] Gjithashtu, thotë: "A nuk shihni se Zoti ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme?"[8]

Lindin pyetjet:

- A e vlerësojmë ne këtë vlerë që na e ka dhënë Krijuesi ynë?

- A po jetojmë ne me ketë vlerë?

- A po u nënshtrohemi disa gjërave, që normalisht, duhet të ishin të nënshtruara ndaj nesh?!

Muslimanët e parë, të pajisur me forcën e moralit dhe të shpirtit, arritën që për gjysmëshekulli të sundonin gjysmën e botës. Ata qëndruan shumë lart në aspektin shkencor, politik dhe kulturor ndaj të gjithë popujve të botës. Bënë përparime të mëdha në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore. Të nxitur nga ajetet e shumta kuranore, që porosisin për lexim, kërkim, meditim, soditje, punë intelektuale dhe marrjen me shkencë, muslimanët i dhanë një kontribut të çmuar njerëzimit. Islami solli një revolucion kulturor të pashembullt. Sidomos sahabët, që zbatuan udhëzimet e Kuranit, arritën të shndërroheshin nga një populli i pashkolluar dhe beduin, në brezin më të mirë të gjithë njerëzimit, prej të cilëve dolën udhëheqësit e mëdhenj që qeverisën një pjesë të madhe të botës. Sahabët poseduan fuqi përfaqësimi, e cila e plotësonte thirrjen në rrugën e Allahut. Pas dashamirësisë së tyre, vinte era e sinqeritetit dhe e seriozitetit. Allahu xh.sh ka thënë: "Më fisniku tek Allahu është ai, i cili është më i lartë në devotshmëri ..."[9].

Pse në kohët moderne, në kohën në të cilën po jetojmë, po shohim nënshtrim ndaj fuqisë, kënaqësisë, interesit, politikës, të kotës, etj.?

Brezat u janë nënshtruar ekraneve, politika u është nënshtruar gënjeshtrave, tregtia kamatës, shoqëria hipokrizisë e reklamave, rinia lojërave, fëmijët institucioneve, e prindërit vendeve të punës. Të gjitha këto po ndodhin, jo vetëm se janë pjesë e kohës ku jetojmë, por edhe sepse kemi hequr dorë nga shumë gjëra që na përkasin. Po ndodhin, sepse nuk po ia dimë vlerën identitetit që bartim. Kemi harruar se njeriu fiton gradë të lartë, jo vetëm në saje të pasurisë, të pozitës e pronave që ka, por edhe në saj të misionit, kauzës dhe vlerave hyjnore për të cilat përpiqet. Njerëzit, veçanërisht të rinjtë, nuk kërkojnë thjesht këshillues, por shembuj konkretë që jetojnë duke praktikuar të drejtën e të vërtetën. Të rinjtë, të cilëve u drejtohemi, me tepër sesa një diskurs të mirë, kanë nevojë për shembull të bukur e për model të mirë.

Për sa kohë do të ecim në rrugën e shpalljes, do të jemi shembull, të vlerësuar, dhe prijës të vlerave. Dhe e kundërta, sa herë që do të largohemi nga kjo rrugë, do të jemi të zhvlerësuar e do të shndërrohemi në hiç. Sa më shumë të thërrasim në gjerësinë e Ahiretit, aq më shumë do të largohemi nga ngushtica e dynjasë dhe problemet e saj! Atëherë do të bëhemi tërheqës e jo të tërhequr, aktivë e jo pasivë, subjekt e jo objekt. Ne do të posedojmë fuqinë e përfaqësimit e do të bëjë jehonë shëmbëlltyra jonë. Do të lëmë gjurmë si në këtë jetë, edhe pas vdekjes.

Le të bëhemi pjesë aktive e identitetit tonë islam, le ta shfaqim me besim, moral dhe me vepra përkatësinë tonë ndaj këtij identiteti.

Le të bëhemi shembuj që nënshtrojnë zemrat, gjymtyrët dhe mendjet ndaj të vërtetës.

Allahu na bëftë muslimanë të denjë, të cilët krenohen me identitetin dhe përkatësinë që bartin!

Përgatiti:
MSc. Zamira Bushati (Puka)
Eljat Zhabjaku

7. Kur'ani, El-Bekare: 29.
8. Kur'ani, Llukman: 20.
9. Kur'ani, El-Huxhurat: 13.

Referencat:

- Ramazan Kajan; Ndërtimi i identitetit nën hijen e shpalljes; Furkan; Shkup, 2016.

- Prof. Dr. Qazim Qazimi; Ruajtja e identitetit fetar në shoqëritë moderne; https://www.zaninalte.al/2019/01/ruajtja-e-identitetit-fetar-ne-nje-shoqeri-moderne/

- Mr.sc. Azmir Jusufi; Identiteti yt krenaria jote; https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=11404

PAKISTANI
OSE REPUBLIKA ISLAMIKE E PAKISTANIT

Pakistani, ose zyrtarisht Republika Islamike e Pakistanit, është një vend në Azinë Jugore. Ai kufizohet me Afganistanin në veri, me Kinën në lindje, me Indinë në jug dhe juglindje, me Iranin në perëndim, dhe vija bregdetare në Detin Arabik formon kufirin e tij jugor. Pakistani ndahet nga Taxhikistani në veri, nga një korridor i ngushtë,"Korridori Wakhan" i Afganistanit. Rajoni i Kashmirit është i ndarë midis Indisë dhe Pakistanit.

Pakistani ka një sipërfaqe prej 796.095 km2. Ai është vendi i pestë më i populluar në botë, me një popullsi prej 231.450.668 banorësh (sipas worldometers, Nëntor, 2022), dhe vendi i dytë me popullsinë myslimane më të madhe në botë.

Kryeqyteti i vendit është **Islamabadi**.

GJEOGRAFIA

Pakistani ka male të larta me borë, pllaja të larta, fusha pjellore të sheshta dhe plazhe me rërë. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar në rajonin Punxhab, një fushë pjellore në lindje të Pakistanit. Islamabadi, kryeqyteti kombëtar, ndodhet gjithashtu në pjesën verilindore të vendit. Pjesa më e madhe e rajonit perëndimor të Pakistanit karakterizohet nga thatësira e madhe, gjë e cila ka bërë që kushtet për bujqësi atje të jenë të papërshtatshme, dhe si rrjedhojë të banohet vetëm nga një numër i vogël njerëzish.

Pakistani ndahet në katër rajone gjeografike kryesore: rajoni verior malor (nëpër të cilin kalojnë vargmalet Karakoram, Hindu Kush dhe Pamir, e në të cilat gjenden disa nga majat më të larta në botë, përfshirë pesë nga 'katërmbëdhjetë tetëmijëshet' (maja malesh mbi 8000 metra), të cilat tërheqin aventurierë dhe alpinistë nga e gjithë bota, veçanërisht K2 (8611 m) dhe Nanga Parbat (8126 m)), rrafshnalta e Baloshistanit, fusha e Lumit Sind (Indus), dhe rajonet e shkretëtirës.

Lumi Sind (Indus) ka një gjatësi 1609 km, dhe ai bashkë me degët e tij rrjedhin nëpër vend nga rajoni i Kashmirit në Detin Arabik. Përgjatë këtij lumi në Punxhab dhe Sind gjenden fusha lymore pjellore.

KLIMA

Temperaturat ndryshojnë në pjesë të ndryshme të Pakistanit, ku zonat malore janë më të ftohtat. Temperatura mesatare në verë, në veri dhe veri-lindje të vendit arrin në 24° C. Në dimër, temperatura në rajonin Punxhab, që ndodhet në lindje të Pakistanin, sillet rreth 32° C në verë dhe rreth 13° C në dimër. Në fushën e Baloshistanit, në Pakistanin perëndimor, temperatura mesatare shkon në 27°C në verë, kurse në dimër zbret në më pak se 4° C. Sa i përket rajonit të bregdetit që ndodhet në jug të Pakistanit, ai karakterizohet nga një klimë e moderuar, e ngopur me lagështi në pjesën më të madhe të vitit, dhe temperatura mesatare atje varion

mes 19° C në dimër dhe rreth 30° C në verë.

Në Pakistan ekziston një sezon musonesh (me përmbytje të shpeshta për shkak të reshjeve të dendura), dhe një sezon i thatë me reshje dukshëm më të vogla. Pakistani ka katër stinë të dallueshme: dimri i freskët dhe i thatë, nga dhjetori deri në shkurt; pranvera e nxehtë dhe e thatë, nga marsi deri në maj; sezoni i shirave të verës, ose periudha e musonit jugperëndimor, nga qershori deri në shtator; dhe periudha e musoneve në tërheqje, në muajt tetor dhe nëntor. Reshjet ndryshojnë shumë nga viti në vit, dhe alternimet mes përmbytjeve dhe thatësirës janë një gjë e zakontë atje.

EKONOMIA

Pakistani ka një ekonomi të kombinuar mes sektorit publik dhe atij privat, megjithëse roli i sektorit publik ka filluar të bjerë kohët e fundit. Sistemi ekonomik pakistanez varet kryesisht nga bujqësia, dhe shumica e shtetasve të Pakistanit e fitojnë jetesën e tyre ose duke punuar në bujqësi, ose duke rritur dhi apo dele. Lumenjtë në Pakistan konsiderohen si një nga burimet natyrore më të rëndësishme në vend, pasi ato ofrojnë ujë që përdoret për të ujitur më shumë se 15 milionë hektarë tokë bujqësore (dhe përveç kësaj, këta lumenj përdoren edhe për të prodhuar energji elektrike). Kur Pakistani fitoi pavarësinë në vitin 1947, vendi kishte një numër të vogël fabrikash, dhe që atëherë Pakistani ka punuar për t'i rritur dhe zhvilluar objektet e tij industriale. Qeveria në Pakistan kontrollon shumicën e industrive të rënda kombëtare, të tilla si rafinimi i naftës së papërpunuar, prodhimi i hekurit dhe prodhimi i çelikut. Shumë programe të zhvillimit ekonomik në Pakistan janë financuar nëpërmjet ndihmës së ofruar nga vende të tjera, si dhe nëpërmjet institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare.

Kultura kryesore që mbillet në Pakistan është gruri, por kultivohen gjithashtu edhe pambuku, orizi, kallam sheqeri, qiqrat, farat vajore, frutat dhe perimet. Rajoni i Baloshistanit në Pakistan njihet për rritjen e dhive dhe të deleve, kurse rritja e shpendëve është e zakonshme në shumicën e pjesëve të vendit.

Industria në Pakistan thith rreth 18% të fuqisë punëtore, dhe jep rreth 20% të prodhimit kombëtar bruto. Industria e tekstileve dhe e pëlhurave të pambukut qëndron në krye të listës së produkteve industriale. Produkte të tjera të rëndësishme industriale atje përfshijnë ushqimet (veçanërisht miellin dhe sheqerin), plehrat e tokës dhe disa produkte të tjera kimike, çelikun dhe çimenton. Pakistani është vendi i parë Islam që arriti të kishte një reaktor bërthamor, në vitin 1986.

Në Pakistanin qendror gjenden fusha të mëdha të gazit natyror, dhe vendi gjithashtu ka rezerva të naftës, qymyrit, mineralit të hekurit, kripës, gipsit, gurit gëlqeror dhe kromit.

GJUHA

Gjuha zyrtare e Pakistanit është anglishtja. Gjuha Urdu është gjuha më e përhapur në vend, dhe ajo ka një bazë të përbashkët me urdishten e përdorur në Indi, por urdishtja e Pakistanit është e ndikuar nga një përzierje persishte-arabishte, dhe shkruhet me shkronja perse.

Në Pakistan fliten edhe gjuhë të tjera lokale si punxhabi, sindi, pashtu, saraki dhe hindku.

FEJA

Myslimanët përfaqësojnë rreth 97% të popullsisë së Pakistanit dhe Islami është lidhja kryesore që bashkon grupet e ndryshme kulturore, që përbëjnë popullin pakistanez. Shumica e popullit të Pakistanit besojnë se kryerja e namazeve, përveç praktikimit të riteve të tjera fetare, përfaqëson një

Kryeqyteti, Islamabad

pjesë të rëndësishme të praktikave dhe aktiviteteve të jetës së përditshme. Festat dhe ngjarjet Islame konsiderohen festa kombëtare dhe pushim zyrtar në të gjithë Pakistanin. Të krishterët përbëjnë 1.5 % të popullsisë së përgjithshme të Pakistanit. Hindusët përbëjnë rreth 2% të popullsisë. Atje ka edhe një numër të vogël budistësh dhe zoroastrianësh.

HISTORIA

Historia e rajonit, që tani njihet si Pakistan, daton të paktën 4500 vjet më parë, kur një qytetërim i përparuar dhe i lulëzuar u shfaq në atë që njihej si lugina e lumit Sind. Rreth vitit 2500 p.e.s, në luginën e lumit Sind (Indus), filloi të lulëzojë një nga qytetërimet më të rëndësishme në botë, dhe ai vend sot njihet me emrin Pakistan. Mbetjet e Harappa dhe Mohenxho-Daro, dy qytetet kryesore të atij qytetërimi, tregojnë se të dy qytetet ishin të mëdhenj dhe të mirë planifikuar. Qytetërimi i luginës së lumit Sind u zhduk në vitin 1700 p.e.s, dhe shkencëtarët e studiuesit nuk kanë arritur të gjejnë një arsye që shpjegon rënien dhe zhdukjen e këtij qytetërimi.

Gjatë mijëvjeçarëve, që pasuan zhdukjen e qytetërimit të luginës së lumit Sind, shumë grupe njerëzish nga Azia jugperëndimore dhe qendrore u dyndën në atë rajon. Rreth vitit 1500 p.e.s, njerëzit u zhvendosën nga Azia Qendrore në Punxhab përmes kalimeve dhe shtigjeve malore, dhe ata njerëz njiheshin si "arianë". Në shekullin e 6-të p.e.s, persianët e futën rajonin e Punxhabit nën ndikimin e tyre, dhe e bënë atë pjesë të perandorisë së madhe Akaemenide. Deri në vitin 326 p.e.s, Aleksandri i Madh kishte shtrirë kontrollin dhe ndikimin e tij mbi shumicën e pjesëve të vendit, që sot njihet si Pakistan. Disa vite më vonë, perandori Chandragupta e aneksoi atë territor, duke e bërë atë pjesë të Perandorisë Maurja. Perandoria Maurja filloi të shpërbëhej rreth vitit 230 p.e.s, dhe grekët e morën sërish këtë rajon.

Në vitin 100 p.e.s, erdhën skathët nga Afganistani dhe u përhapën në pjesët e Baloshistanit dhe Sindit, dhe më pas e vunë provincën e Sindit nën sundimin e tyre. Më pas këta të fundit u zëvendësuan nga partët. Kushanët që erdhën nga Azia Qendrore i mundën partët dhe zunë vendin e tyre. Kushanët sunduan rajonet që njihen sot si Afganistani, Pakistani dhe India veriperëndimore, në periudhën mes vitit 50 dhe mesit të shekullit të 3-të e.j. Ata e forcuan kontrollin e tyre mbi rrugët dhe kalimet tregtare të ndodhura mes Kinës, Indisë dhe Lindjes së Mesme.

Peshauar, kryeqyteti i Perandorisë Kushan të atëhershme, u bë një qendër kryesore tregtare. Në mesin e shekullit të katërt e.j, rajoni i Luginës së Lumit Sind u bë pjesë e Perandorisë Gupta, ndikimi i së cilës shtrihej nga India verilindore në perëndim. Më pas, në mesin e shekullit të 5-të e.j, Hunët nga Azia Qendrore e pushtuan perandorinë dhe e futën nën sundimin e tyre. Ky qytetërim zgjati 800 vjet, pastaj u zbeh dhe u zhduk.

Një mijë vjet më vonë, disa grupe të ndryshme u vendosën në zonën që më vonë u quajt Pakistan. Sundimi i këtij rajoni ka qenë radhazi... nga persianët, grekët, arabët myslimanë, turqit dhe të tjerë, para se të vihej nën kontrollin e Britanisë, në shekullin e 19-të (e.j).

Lëvizja e Pakistanit, e cila kërkonte një atdhe për muslimanët e Indisë

12

Xhamia Fejsal, Islamabad

Britanike, dhe fitorja e Lidhjes Muslimane Gjith-Indiane në zgjedhjet e bëra në vitin 1946, bënë që Pakistani të fitonte pavarësinë më 14 Gusht të vitit 1947, pas Ndarjes së Perandorisë Britanike Indiane, e cila i dha Pakistanit një shtetësi të veçantë për të.

SI ERDHI ISLAMI NË PAKISTAN

Ajo që e shtyu Haxhaxhin (një nga guvernatorët më të shquar të Kalifatit Umejad, në Irak) të përgatiste një fushatë ushtarake dhe për ta dërguar në ato anë, ishte se disa piratë që i përkisnin rajonit të Sindit, nga "Med Ed-Dibal", kishin sulmuar një anije që vinte nga ishulli Sejlon (Sri Lanka), në të cilën gjendeshin disa gra muslimane të veja të disa tregtarëve muslimanë, që kishin vdekur në atë ishull, dhe bashkë me ato gra ishin edhe vajzat e tyre. Haxhaxhi i dërgoi një mesazh Dahir-it, mbretit të Sindit, ku i kërkonte që t'i linte të lira ato gra. Por Dahir u justifikua duke thënë se ishte i pafuqishëm për t'i mposhtur ata piratë, kështu që Haxhaxhi dërgoi një forcë të shpejtë, të udhëhequr nga Abdullah ibn Nebhan, që përfundoi me humbje. Pastaj dërgoi një forcë tjetër, të udhëhequr nga Budejl ibn Tahfa El-Bexhelij, që dolën nga Omani drejt Indisë, por edhe ajo u mund.

Atëherë, Haxhaxhi vendosi t'i kërkonte leje kalifit El-Velid ibn Abdul-Melik ibn Mervan, që të sulmote Sindin (Pakistanin e sotëm), dhe miratimi i kalifit në mbështetje të Haxhaxhit nuk vonoi e erdhi. Tani Haxhaxhi do të vinte në krye të fushatës ushtarake një figurë të re, të shquar, kushëririn e tij Muhamed ibn El-Kasim Eth-Thekafij, i cili ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç kur e filloi rrugëtimin për të marrë Sindin, në vitin 93 hixhri.

Ushtria e Muhamed ibn El-Kasim Eth-Thekafij rreshtoi plot dymbëdhjetë mijë burra, në Shiraz, dhe ata marshuan nga Persia në jug, drejt Makranit, përgjatë Detit Arabik, dhe prej andej në Dibal, rajoni më i famshëm i Sindit (Pakistanit), afër Karaçit sot. Atje, anëtarët e dy fiseve Sindi, El-Meid dhe El-Xhat "El-Zat", shumë prej burrave të të cilëve kishin emigruar jashtë vendit për shkak të keqtrajtimit dhe abuzimit të qeverisë Berhemije ndaj tyre, iu bashkuan ushtrisë muslimane. Muslimanët përfituan shumë nga këta njerëz, për shkak të njohurive që ata kishin për rrugët dhe shtigjet e atyre vendeve, përveç guximit dhe qëndrueshmërisë së tyre në luftëra dhe beteja.

Myslimanët iu afruan qytetit Dibal, në jug të Sindit (Pakistani jugor). Komandanti Ibn El-Kasim filloi të shtrëngonte rrethimin e tij mbi qytetin, dhe më pas filloi sulmin, duke rrënuar muret dhe shtëpitë me katapultën e tij të madhe, të quajtur "Nusja". Midis banorëve të atij vendi u përhap paniku dhe kaosi, kurse mbreti i tij, Dahir,u arratis. Muhamed ibn El-Kasim mori qytetin dhe u dha siguri banorëve të tij për jetën dhe pasurinë e tyre.

Më pas, Muhamed ibn El-Kasim marshoi drejt qytetit "El-Bijrun" (Hajderabadi sot), dhe bëri marrëveshje me njerëzit e atij vendi, kështu që e mori qytetin pa luftë. Pastaj ai e vazhdoi marshimin e tij, dhe nëpër çdo qytet ku shkelte, ai e merrte atë, qoftë më marrëveshje apo me luftë. Kështu vazhdoi, derisa mbërriti në brigjet e lumit Mihran. Ai e kaloi lumin, ndërkohë që Dahir e priste në anën tjetër, për t'u hedhur mbi të në një betejë vendimtare. Një nga dëshmitarët okularë muslimanë që morën pjesë në këtë fushatë, tregon: Dahir erdhi tek ne, në një tubim të madh, dhe me vete kishin njëzet e shtatë elefantë. Ne kaluam në anën e tyre, dhe Zoti i mundi ata. Dahir u arratis. Pastaj një grup muslimanësh i ndoqën armiqtë dhe i vranë, pastaj u kthyen në ushtri. Kur u bë natë, Dahir erdhi sërish me një numër të madh ushtarësh, por Dahir dhe shumica e ndjekësve të tij u vranë, kurse pjesa tjetër u mund.

Vrasja e Dahir-it paralajmëroi hapjen e rrugës për Muhamed ibn El-Kasim dhe për forcat muslimane që të depërtonin lirshëm në tokat e Sindit. Kështu që ata u drejtuan për në veri, në rajonin e Rurit, dhe njerëzit atje i pritën të dorëzuar dhe po kërkonin vetëm siguri dhe paqe. Kështu vazhdoi marshimi i ushtrisë muslimane derisa arriti në qytetin Multan, ku njerëzit atje e pritën me luftë. Kjo ishte një nga zonat më të rëndësishme dhe më të dendura të Sindit, dhe është një nga bazat e provincës Punxhab, por pas një rrethimi të ashpër, edhe ata u mundën, dhe muslimanët dolën fitimtarë.

Përparimi i muslimanëve drejt veriut nuk u ndal, derisa arritën në qytetin e Brahmanabadit, vend ku ishte strehuar njëri nga djemtë e Dahir-it, i quajtur Xhaj Sink. Ky e kishte fortifikuar qytetin dhe i kishte bllokuar të gjitha hyrjet e tij. Muslimanët e sulmuan qytetin në mënyrë të befasishme dhe me forcë, dhe djali i Dahir-it nuk pati zgjidhje tjetër veçse të ikte më thellë në veri, duke kërkuar strehim te mbreti i Kashmirit. Muhamed ibnEl-Kasim me forcat e tij u vendosën në këtë qytet për një periudhë kohore, gjatë së cilës ai menaxhoi çështjet e zonave që i kishte marrë dhe organizoi administrimin e tyre. Emri i Ibn El-Kasim-it u bë i njohur në gjithë Botën Islame.

Ibn El-Kasimi la tokën e Sindit dhe një pjesë jo të vogël të provincave të Indisë në gjirin e Islamit.

Nuk shkoi shumë kohë kur thirrësit muslimanë filluan punën e tyre për të përhapur Mesazhin Islam në ato vende dhe për të ngritur xhamitë atje. Burrat si Malik ibn Dinar, të njohur për devotshmërinë e tyre në fe, u bënë të famshëm në mesin e banorëve të Sindit dhe Indisë jugore, dhe puna e tyre nxori frytet e saj, e njerëzit filluan të hyjnë turma-turma në fenë e Allahut.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://en.wikipedia.org
https://ar.wikipedia.org
https://www.aljazeera.net
https://www.marefa.org

MYFTIU I SHKODRËS: "ME DASHTË VENDIN TËND DHE TOKËN TËNDE, ËSHTË NATYRË ME TË CILËN TË KA SJELLË ZOTI NË KËTË BOTË, SI MËKËMBËSIN E TIJ!"

Me ftesë të Komunitetit Shqiptar Mysliman në Bjenë të Zvicrës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në aktivitetet e larmishme që ky komunitet organizoi me rastine "Javës Kombëtare 21-27 nëntor 2022".

Myftiu ligjëroi ditën e xhuma, më 25 nëntor 2022, nga kursija dhe minberi i xhamisë "Ebu Bekër Es-Siddik", ku hodhi dritë mbi argumentet e shumta që e nxisin besimtarin për të dashur vendin e tij, për ta mbrojtur tokën, për të punuar me plot përkushtim mbi të në gjurmët e njerëzve më të mëdhenj të gjithësisë, të dërguarit e Allahut, që jetuan me dinjitet dhe përhapën dritën e udhëzimit për të mirën e njerëzimit deri në kiamet.

Myftiu theksoi se në jetën e muslimanit ka vend edhe për kombin dhe marrëdhëniet e dëshmuara në rrugën e sigurisë dhe harmonisë kombëtare, sikurse na e dëshmon këtë Kur'ani Famëlartë dhe traditat e Hz. Muhammedit (a.s).

Ndërkohë, në hytben e xhumasë, Myftiu Sytari dha një mesazh të prerë se kontributi më i mirë që mund të bëjmë sot për tokën tonë, për kombin dhe mbarë njerëzimin, kudo qofshim, është edukimi i fëmijëve, vajzave dhe djemve, me moralin e fesë, me edukatën islame, me dije e përkushtim ndaj Zotit, tokës dhe njeriut!

Myftiu I Shkodrës ishte pjesëmarrës me një fjalë përshëndetëse edhe në konferencën me temë: "Mbi rëndësinë e atdheut në Islam: shembuj nga historia kombëtare", ku referuan të nderuarit Mr. Fehim Abazi dhe Dr. Besim Nuzi.

Ndërkohë, në ditën vijuese, Imam Muhamed B. Sytari, bashkë me analistin Redi Shehu dhe H. Mehas Alija (Kryetar i KMShZ), ishin referues në konferencën me temë: "Identiteti kombëtar dhe ai fetar në gjurmët e hoxhallarëve të shquar shqiptarë". Konferenca u përmbyll me fjalët e imamit të xhamisë së Bjenës, H. Emin Odai, i cili falënderoi miqtë dhe të ftuarit, besimtarët dhe familjet e tyre, për mbështetjen dhe gjallërimin e këtyre aktiviteteve me praninë e tyre. Në veçanti u falënderuan miqtë e ardhur

nga Nurnbergu i Gjermanisë dhe Gjeneva.

Aktivitetet e këtyre ditëve u zbukuruan edhe nga programi i veçantë i nxënësve të xhamisë, që nën drejtimin e mësuesit të gjuhës shqipe, Arel Bekteshi dhe kryetarit Mustafë Veseli, kënaqën dhe emocionuan të pranishmit me recitimet e tyre plot pathos dhe dlirësinë e moshës.

Gjatë qëndrimit në Bjenë, në mikpritje të kryetarit Veseli, Myftiu i Shkodrës pati rast të vizitojë edhe Muzeun e Civilizimeve Islame (Musée des civilisations de l'Islam) në La Chaux-de-Fonds.

INTERVISTË ME ZNJ. HAVA MALOKU: QËLLIMET E LARTA DO T'JU SHËRBEJNË SI MOTIVUES PËR JETËN TUAJ

"LinkedIn" ka mbi 830 milion anëtarë nga 200 vende të botës. Prej tyre 85 mijë janë në Kosovë dhe 430 mijë në Shqipëri. Sa u përket bizneseve, mbi 58 milion biznese kanë faqe në "Linkedin" dhe mbi 120 mijë shkolla. Në Kosovë kemi 555 biznese, ndërsa në Shqipëri 6600.

E nderuara znj. Maloku, fillimisht ju urojmë për arritjet e sukseset tuaja në avancimin tuaj profesional, njëherësh shprehim kënaqësinë që të jeni pjesë e intervistës për revistën e përmuajshme "Dituria Islame".

A mund të na rrëfeni pak rreth rrugëtimit të shkollimit tuaj? Pra, ku keni lindur dhe ku keni kryer shkollimin e mesëm, e pastaj edhe ku keni vazhduar studimet tuaja të mëtutjeshme?

Kam lindur në Gjilan, kam jetuar vetëm dy vitet e para të jetës, pastaj prindërit janë zhvendosur në lagjen Bregu i Diellit, në Prishtinë. Shkollimin fillor e kam përfunduar në shkollën "Ismail Qemali", ndërsa atë të mesëm në gjimnazin "Xhevdet Doda". Pas përfundimit të gjimnazit, kam fituar një bursë për studime në "Graceland University" që gjendet në Iowa të ShBA-ve. Për tri vite kam përfunduar dy drejtime në fakultetet "Marrëdhënie të Biznesit" dhe "Biznes Internacional me orientim në Teknologji Informative". Për studimet e masterit, vendosa të shkojë në San Francisko, ani pse nuk e kisha vizituar asnjëherë, por Silicon Valley sa kishte filluar të bëhej edhe mendova që është një mundësi e mirë për të qenë aty. Masterin në Biznes dhe Administrim (MBA) e kam përfunduar në "University of San Francisco" dhe me të përfunduar kam filluar me punë në San Francisko. Ndërkohë kam përfunduar edhe doktoratën në "Golden Gate University" në drejtimin e Marketingut.

Prej sa vitesh jetoni e punoni në ShBA, dhe çfarë statusi gëzoni atje aktualisht?

Në ShBA jetoj dhe veproj qe 19 vjet. Kam shtetësinë e dyfishtë, atë të Amerikës dhe të Kosovës.

Po rreth kompanisë ku jeni e punësuar, a mund të na rrëfeni profilin e saj, veprimtarinë biznesore dhe kapacitetet e saj kapitale dhe ato të fuqisë punëtore?

"LinkedIn" është rrjeti social kryesor në botë për profesionistë. Me fjalë të tjera është një platforme digjitale që ju ofron anëtarëve të tyre të krijojnë faqen personale ku mund ta paraqesin një lloj pasqyre profesionale për veten. Aty përfshihen edukimi, eksperienca e punës, rolet, aftësitë e tyre, rekomandimet dhe arritjet. Ata gjithashtu mund të bëhen pjesë e grupeve të ndryshme ku diskutohet për tema të caktuara që kanë interes, mund t'i ndjekin faqet e kompanive apo shkollave që ju interesojnë. Në përgjithësi është një platformë ku mund të gjejnë punë, të krijojnë kontakte dhe të lidhen me profesionistë e kompani nga më të ndryshmet.

"LinkedIn" ka mbi 830 milion anëtarë nga 200 vende të botës. Prej tyre 85 mijë janë në Kosovë dhe 430 mijë në Shqipëri. Sa u përket bizneseve, mbi 58 milion biznese kanë faqe në "Linkedin" dhe mbi 120 mijë shkolla. Në Kosovë kemi 555 biznese, ndërsa në Shqipëri 6600. Arsyeja pse ekziston kjo diferencë kaq e madhe e anëtarëve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është se në fillim Kosova s'ka ekzistuar si shtet në "LinkedIn", prandaj njerëzit e kanë zgjedh Shqipërinë si shtet. Tash që Kosova ekziston si shtet në platformë, anëtarët mund ta ndërrojnë shtetin direkt në profilin e tyre.

Sa u përket të hyrave "LinkedIn" gjeneron 11.5 miliard dollarë. Nëse i shikojmë statistikat, 50 milion njerëz kërkojnë punë çdo javë, 122 milion njerëz kanë pasur të paktën një intervistë përmes "LinkedIn", 95 aplikacione krijohen çdo sekondë dhe 3 njerëz punësohen çdo minutë.

Si keni arritur të përzgjidheni në kompaninë ku punoni, me çfarë kriteresh dhe a ka shqiptarë të tjerë në të?

Për të arritur deri këtu është dashur një punë e përvojë e madhe. Kur kam aplikuar kam pasur një përvojë të gjerë në fushën e marketingut dhe të teknologjisë dhe një shkollim të duhur. Kam pasur dhjetë intervista të ndryshme me pyetje prej marketingut, teknologjisë e deri ato matematikore dhe psikologjike. Përmes këtyre intervistave dëshirojnë me ditë se a je i përgatitur jo vetëm profesionalisht, por edhe emocionalisht, si e menaxhon stresin, punën në presion etj.. Por mendoj që është edhe pak fat se shumë e shumë njerëz të kualifikuar aplikojnë në çdo çast e nuk përzgjidhen për intervistë. Ndonjëherë për një rol të vetëm numri i aplikantëve shkon në mbi 1500 persona. E kuptohet që shumica prej tyre janë të aftë dhe të suksesshëm. Nganjëherë ndodhemi në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.

Ju çfarë pozite mbani në këtë kompani?

Sa i përket rolit tim, unë menaxhoj produktin më të madh në "LinkedIn", LinkedIn Premium. Me fjalë tjera, e menaxhoj marketingun online, përmes emailit dhe web faqeve për Linkedin Premium. Premium është një produkt me pagesë ($29.99 për muaj) që i shtohet profilit dhe si rezultat anëtari me premium ka qasje në LinkedIn Learning, ku mund të ndjekë klasa online, duke marrë parasysh librarinë prej më shumë se 15,000 klasa. Gjithashtu ka mundësi të dërgojë mesazhe edhe anëtarëve që nuk janë pjesë e shoqërisë, ka mundësi në mënyrë anonime t'i shikoj profilet e anëtarëve të tjerë dhe kur të bëjnë aplikimin për punë e kuptojnë se ku radhiten në krahasim me aplikantët e tjerë. P.sh. top 10%, do të thotë je në top 10% e anëtarëve më të kualifikuar prej të gjithëve që kanë aplikuar. Roli që kam ka përgjegjësi të madhe, vetëm në një jave kam dërguar mbi 130 milion e-maila anëtarëve. Që do të thotë se kujdesi duhet të jetë maksimal që gjithçka të jetë korrekte se ndikon në tërë brendin e kompanisë.

A mendoni se ndonjëherë jeni paragjykuar për prejardhjen tuaj, religjionin apo eventualisht edhe për pamjen tuaj mbulesën?

Në Amerikë secili respektohet dhe vlerësohet për punën që bën, e jo për prejardhjen, fenë, apo racën. Në kompaninë që punoj kemi dhomën e lutjeve, ku mund t'i kryejmë obligimet e namazit. Edhe për ushqim kemi shenja të ndryshme se çfarë përbërës ka që të jetë sa më konform besimeve tona. Në Amerikë të pranojnë ashtu siç je, në fakt të çmojnë edhe më shumë nëse je vetvetja.

Një intelektualeje sikur jeni ju, besojmë se ka detyrë edhe ta përfaqësojë vendin e saj në vendin ku jeton e vepron në nivelin më të mirë të mundshëm. E, ju si punonjëse e një kompanie prestigjioze amerikane, a mendoni se duhet ta luani edhe rolin e një "ambasadoreje" të shtetit tonë?

Patjetër, çdoherë, jo vetëm unë, por secili shqiptar në diasporë është ambasador i vendit të tij. Prandaj duhet të kemi kujdes se si sillemi se jemi pasqyrë e tërë kombit.

Cili ka qenë motivi juaj i vazhdueshëm që ju ka shtyrë drejt sukseseve në karrierë, dhe i cili nuk iu hiqet nga mendja asnjëherë?

Motivi kryesor kanë qenë prindërit. Ata kanë sakrifikuar shumë që ne, fëmijët, të arrijmë këtu ku jemi. Jam fëmija i madh i një familje të madhe që përbëhet nga 6 fëmijë dhe 2 prindër. Të dy prindërit janë me profesion arsimtar të gjuhës dhe letërsisë shqipe, ndërsa ne të gjashtë fëmijët kemi studiuar në ShBA në fusha të ndryshme. Një vëlla dhe një motër janë rikthyer të kontribuojnë në Kosovë në fushën e biznesit, një motër vazhdon me studime në biokimi në Cyrih dhe vëllai e motra e vogël janë në përfundim të magjistraturës për Shkenca Kompjuterike në San Francisko. Prindërit e mi nuk kanë pasur shumë kapital apo pozita kyçe në Kosovë, por na kanë rritur me shumë dashuri të madhe dhe na kanë shty të mendojmë se me punë arrihet gjithçka. Edhe para lufte, kur situata në Kosovë ka qenë shumë e tensionuar na kanë këshilluar që të përgatitemi, sepse mundësia vjen vetëm një herë në jetë, e nëse nuk jemi gati, nuk mund ta kapim.

Çfarë obligimi ndieni ju tani ndaj vendit tonë, kur jeni larg tij në një vend tej oqeanik?

Nuk e kisha thanë obligim, por një dëshirë të madhe me pa vendim tim duke përparuar. Andaj kjo të shtyn të mundohemi sa ma shumë të kontribuojmë që ta çojmë Kosovën përpara.

Krejt në fund, cilat do të ishin porositë tuaja për brezin e ri që premton një të ardhme të ndritur për vendin tonë?

Unë do ta ndaja mesazhin tim për të rinjtë në tri pika:

- Vendosi vetes qëllime të larta në jetë. Qëllimet e larta në jetë do t'ju shërbejnë si motivues për jetën tënde. Vendosja e qëllimeve ndihmon të qëndroni të motivuar dhe ju japin një fokus në jetë. Gjithashtu ju ndihmojnë ta mposhtni zvarritjen e punëve. Këtu vlen të theksohet edhe menaxhimi i tyre. Qëllimet e mëdha duhet të ndahen në ato më të vogla deri në ato ditore. P.sh. sot kam qëllim ta lexojë një faqe të një libri. Nëse çdo ditë e lexoj nga një faqe, në fund të vitit kam lexuar 365 faqe. Ne shqiptarët e kemi një thënie "Pika, pika mbushet pusi." Nëse qëllimet e mëdha i ndajmë në të vogla, atëherë gjithçka është e arritshme. Nuk ka qëllime të paarritshme.

- Sa ma shumë networking. Networking është proces i bashkëveprimit me të tjerët për të shkëmbyer informacione dhe për të zhvilluar kontakte profesionale ose sociale. Networking apo lidhja me njerëz kontribuon në mirëqenien tuaj sociale, çon në shkëmbimin e ideve dhe ju ndihmon të takoni njerëz në të gjitha nivelet profesionale. Kjo vlen si për shkollë, ashtu edhe për punë. Nuk është vetëm në Kosovë që e marrin punën me të "njohshëm". Edhe në Amerikë ndodh po e njëjta gjë. Nëse krijoni atë rrjetin tuaj profesional, shumë më lehtë përparoni.

- Ec me kohën. Nëse nuk mësojmë dhe avancohemi çdo ditë, shumë lehtë dalim nga tregu. Gjërat që kanë funksionuar para 10 vjetëve nuk funksionojnë më. Puna po ndryshon dita-ditës. Nuk mjafton vetëm me përfunduar një fakultet edhe je i aftë për punë. Në fakt, shkolla ta jep një shprehi pune, por jo më shumë. Shumicës prej nesh as që na kujtohen gjërat që i kemi mësuar në shkollë. Duhet të jemi të hapur të mësojmë gjëra të reja si në punë ashtu edhe jashtë saj. Vetëm në atë mënyrë mund të përparojmë.

Intervistoi: **D.A.**

("Dituria Islame", nr. 381)

NDËRROI JETË MUEZINI I XHAMISË DËRGUT, H. SHEUKI B. DIBRA

"Të Allahut jemi, dhe tek Ai do të kthehemi!"

Në moshën 85 vjeçare, më 1 nëntor 2022, ndërroi jetë muezini i xhamisë Dërgut, i nderuari z. Sheuki B. Dibra.

Rahmetliu Sheuki Dibra:

– Ka qenë aktivist kujdestar i mirëmbajtjes së zyrave të para të Mytinisë Shkodër, ku fillimisht në vitin 1991 kanë qenë në shtëpinë e e familjes "Baja".

– Ka shërbyer për disa vite muezin në xhaminë e Rusit.

– Për dy vite 2004-2006 ka qenë edhe imam në xhaminë Omaraj.

– Pastaj në fund për 10 vite muezin në xhaminë Dërgut.

Myftinia Shkodër shpreh ngushëllimet e saj për familjarët dhe për mbarë besimtarët e Shkodrës.

Allahu e shpërbleftë sakrificën, shërbimin dhe shembullin tënd, i nderuar z. Sheuki Dibra!

Qofsh në mëshirën e Allahut!

MYFTIU: “NJË MUSLIMAN NUK BËHET PALË ME SHEJTANIN PËR TË ZHVATUR VAKËFET!”

Nëpërmjet hytbes së xhumasë, më 11 nëntor 2022, nga minberi i xhamisë së Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, rihapi sërish temën e nxehtë të vakëfeve të Shkodrës.

“Në duart e mia kam ca lista, ku kemi numrin e vakëfeve të sotme të Shkodrës. Vakëfet e kthyera. Pa përmendur betejat e përditshme që kemi me institucionet tona, këtu në Shkodër e atje në Tiranë, ku përveç përpjekjes tonë të vazhdueshme, duhet të përballemi edhe me zigzaget dhe hipokrizinë e dikujt që të qesh në fytyrë e të ngul thikën pas shpine!”, – tha Myftiu.



Pastaj vazhdoi: “Një person që i thotë vetes musliman, kurrsesi nuk mundet të tolerojë e të pranojë të bëhet palë me shejtanin e mallkuar për të zhvatur vakëfet e muslimanëve. Sepse është ngulitur në vetëdijen e disa të pashpresëve ajo çfarë terrorizmi komunist i mësoi njerëzve: ‘është mall vakuf!’... ‘Është mall vakuf’, tek të pafetë!”, – vijoi hytben e tij Imam Sytari.

Poashtu i bëri thirrje institucioneve: “Thirrja ime për të gjithë drejtuesit e institucioneve, nga i pari i qeverisë, tek i pari i bashkisë dhe çfarë ka mes tyre; ta kenë frikë Zotin në hakun e vakëfeve të muslimanëve!..”

DR. SALAHUDIN KEFTARO: “RIKTHIMIN E LIRISË SË BESIMIT NË SHQIPËRI, E NDOQA ME LOT NË SY!”

Në një ligjëratë plot mesazhe të urta dhe udhëzime të dobishme për të gjithë, Dr. Salahudin Keftaro, miku i shtrenjtë nga Damasku i Sirisë, iu drejtua të ftuarve në aktivitetin e organizuar nga Myftinia Shkodër, të shtunën, më 12 nëntor 2022.

Në prani të imamëve, thirrësve, studenteve, pedagogëve dhe intelektualëve të ftuar, Dr. Keftaro theksoi se: “Shqipërinë e shohim si vendin simbol të bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare, vend që e dua përherë e më tepër, pasi gëzohem me qetësinë, atmosferën e sigurisë dhe besimin në mesin e njerëzve!”

Ai tha se: “Periudha aktuale, në të cilën ju përkujtoni rilejimin e besimit dhe fesë, me sjell ndër mend simbolikën e ndritur të Hafiz Sabri Koçit, me pamjen e tij madhështore, në atë ditë të shënuar që e ndoqa me lot në sy dhe, kuptova se kjo dritë e besimit nuk shuhet kurrë!”

Dr. Salahudin Keftaro ftoi të pranishmit të reflektojnë rreth faktit se: “Ardhja e Islamit me urdhëresën hyjnore: ‘Lexo!’, është një kapërcim cilësor nga injoranca në dije, nga groposja e vajzave të mitura në groposjen e veseve të liga dhe prapambetjes!”.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se: “Simbolikat e rimëkëmbjes islame, si dita historike e 16 nëntorit 1990, ku në Shkodër, tek Xhamia e Plumbit, u realizua falja e xhumasë dhe tubimi madhështor i besimtarëve, që po dëshmonin për madhështinë e besimit dhe fesë; janë bekime hyjnore, që na jepen për të na ftuar të shohim veten në pasqyrë!”

Poashtu, duke i uruar mirëseardhjen në Shkodër, mendimtarit islam nga Damasku, tha: “Vizita e Dr. Salahudin Keftaro në Shkodër, është një bekim që na fton të shohim veten në pasqyrën e asaj se ku duhet të jetë Thirrja Islame dhe rrugëtimi i ymetit tonë!”.

VEPRIMTARI DHE TAKIME TË DOBISHME MË NXËNËSIT E MEJTEPEVE FETARE

Nën kujdesin dhe organizimin e sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër gjatë muajit nëntor 2022 u zhvillua një veprimtari arsimore dhe argëtuese me nxënësit e mejtepit të xhamisë Oblikë.

Sipas programit u zhvillua një konkurs brenda grupit, bisedë fetare, si dhe u dhanë vlerësime me certifikata nga vetë mësuesi Nadi Braqi, për disa nxënës të spikatur e të dalluar në përgatitje dhe pjesëmarrjen e tyre të vazhdueshme në kursin fetar.

Më pas, nxënësit kaluan edhe çaste të shijimit të ëmbëlsirave dhe gatime të ndryshme, për përgatitura enkas për ta.

Nga ana tjetër, po në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve dhe takimeve me mejtepet fetare, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim me nxënësit e mejtepit fetar të xhamisë Shirq-Mushan, të cilët marrin mësim nga mësuesi apasionant, H. Kujtim Cufaj .

Gjatë një bisedë të shkurtër, teologu Halluni u foli për disa vlera edukative dhe u dha këshilla të dobishme për këtë brez të ri që kërkon vëmendjen dhe kujdesin e të gjithëve.

MEJTEPI IM... XHAMIA E LAGJES AJASËM

Pak histori:

- Xhamia Ajasëm, ndodhet në Njësinë Administrative të Bashkisë Shkodër.

- Aktualisht, përbëhet prej rreth 30 familje myslimane.

- Familjet më të vjetra janë: Dhembi, Uruçi, Mani, Rroji, Kullolli, Piroviç, etj.

- Xhamia e re e Ajasmës, që është një prej lagjeve më të vjetra të Shkodrës, është ndërtuar në vitin 1997 me kontributin financiar të përbashkët të banorëve të lagjes, të Myftinisë Shkodër dhe të donatorëve të ndryshëm. Xhamia është ndërtuar në një vend vakëf, në njërën nga varrezat e lagjes. Për ndërtimin dhe më pas për mirëmbajtjen e kësaj xhamia është angazhuar në mënyrë të veçantë, H. Latif Ura.

- Sipas librit, “Shkolla Ajasëm, 1917-2017, Dije të përcjella në 100 vite”, midis objekteve të rëndësishme të lagjes Ajasëm, gjithmonë përmendet mejtepi e më vonë shkolla Ajasëm. Mejtepi ishte ndërtuar me kontributin e banorëve të lagjes, në oborrin e xhamisë.

- Imamët dhe mësuesit e mejtepeve që kanë shërbyer në këtë xhami pas ndërtimit të xhamisë së re e në vazhdim janë: Jup Muharremi, Naim Drijaj, Bledar Xama, Erkan Shengyn, mesuese Teuta Uruçi, Alban Kali dhe Agron Kastrati.

- Numri i nxënësve, të cilët kanë frekuentuar rregullisht rreth 21 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002-2022 është rreth 170 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Në vijim të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi më 5 nëntor 2022 një takim me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Ajasëm.

Drejtuesi i arsimit, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën, që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përçimin te brezi i ri të mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit Fuqiplotë.

Në fund të takimit, në kuadër të muajit të Mevludit Sherif, fëmijët e mejtepit u qerasen me asortimente të ndryshme ëmbëlsirash.

Teologu Halluni falënderoi mësuesin e mejtepit, z. Agron Kastrati, i cili me përkushtim të pandërprerë angazhohet në edukimin e brezit të ri më mësimet e vërteta islame dhe sipas traditës fetare dhe kombëtare.

NË XHAMINË E TRUSHIT KËNDOHET MEVLUDI SHERIF

Ditën e xhuma, më 18 nëntor 2022 , në xhaminë e fshatit Trush u zhvillua aktiviteti i këndimit tradicional të Mevludit Sherifë, në përkujtim të Lindjes së Begatë, dërgesës dhe mesazhit të Resulullahut, të Dërguarit të fundit, Hz. Muhammedit (a.s).

Krahas shumë besimtarëve të fshatit Trush dhe zonave përreth, merrnin pjesë edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, imami i xhamisë së fshatit Trush, H. Jetmir Braqi, si dhe imamë dhe hoxhallarë të xhamive të ndryshme të qytetit dhe fshatit.

Myftiu i Shkodrës, në fjalën e tij para të pranishmëve, dha disa këshilla të dobishme që lidhen me mesazhin dhe urtësinë e dërgesës së Hz. Muhammedit (a.s), si Vulë e të dërguarve dhe si udhëzimi i mjaftueshëm për mbarë botët.

Myftiu falënderoi imamin e xhamisë së Trushit, H. Jetmir Braqi, për përkushtimin e madh me rininë dhe fëmijët e kësaj zone, si dhe angazhimin e dëshmuar për të mirën e xhamisë dhe fshatit Trush.

Në vijim të programit, kënduesit e Mevludit, H. Elvis Molla, H. Vullnet Pishtari, H. Bujar Haxhani dhe H. Elsamet Tula përcollën para të pranishmëve pjesë nga "Mevludi Sherifë", salavate, dua-hatme, ilahi, etj.

IMAM MUHAMED B. SYTARI, MESAZH PËR SITUATËN E PËRMBYTJEVE NË SHKODËR

Përmes një videoje të publikuar në profilin e tij në facebook dhe youtube, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari është shprehur:

"Sot jemi më 20 nëntor 2022, dhe kjo është pamja e frikshme e përmbytjes, që ka ndodh në 24 orët e fundit, në zonën e xhamisë së Plumbit. Këtu nuk është në diskutim përmbytja e një objekti, si xhamia e Plumbit, që e kemi përzemër dhe është simbol i identitetit tonë islam e kombëtar, por është në diskutim, patjetër dhe mbi të gjitha, situata e familjeve dhe e njerëzve, në shtëpitë përreth.

Realisht kjo pamje më kujton përmbytjen e frikshme në vitin 2010, kur vinim me mjete të larta dhe ku, pothuajse ishte e pamundur të lëvizej në këto zona, dhe ku njerëzit ishin izoluar, e nuk kishin bukë e ujë dhe energji për sa e sa ditë.

Ne lutemi me zemër, që të mos përsëritet ajo fatkeqësi e atij viti, por pamja e sotme është e atillë, sa gati-gati

sjell në hatër atë periudhë disaditore, në të cilën këta njerëz panë llahtar me sytë e tyre.

Allahu e bëftë mirë dhe qoftë në ndihmë të këtyre familjeve dhe njerëzve!

Edhe pse jemi në vitin 2022, nuk është zgjidhur akoma problemi i përmbytjeve të tokave të tyre. Besoj, se ky është një alarm për institucionet, që duhet ta shikojnë me shumë përgjegjësi këtë zonë, sepse është gjithçka e mundur, për t'u evituar kjo përmbytje, për t'u pastruar Buna, për t'u thelluar Buna, për t'u rregulluar argjinatura e Drinit dhe për t'u rregulluar shkarkimet e hidrocentraleve!

Zoti e bëftë mirë!"

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Myftinia Shkodër

www.myftinia-shkoder.org

SELAM,

do të thotë mos t'i bëjë keq asnjëri prej nesh, tjetrit!

Ndërsa IMAN,
në kuptimet e tij të gjalla dhe,

ISLAM

në kuptimet e tij përmbledhëse,
DO TË THOTË TË LUMTUROJË GJITHSECILI PREJ NESH, TJETRIN!

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek